



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 22.02.2025

Nr: 142

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

MOS FILLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE BAZUAR NË
DENONCIMIN NR. 35 ID, DATË 18.02.2025, TË REGJISTRIT TË
DENONCIMEVE, TË PARTISË DEMOKRATIKE/PD

Sot më datë 22.02.2025, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi mori në shqyrtim paraprak denoncimin me:

KËRKUES: Partia Demokratike

SUBJEKT: **Z. Armando Subashi**
Kryetar i Bashkisë Fier

OBJEKT: Konstatim i kryerjes së veprimtarive të ndaluara, nga neni 91 i Kodit Zgjedhor dhe Vendimi nr. 9/2020 i Komisionit Rregullator, miratimi i akteve nënligjore dhe propozimi për dhënien e ndihmave për një kategori të caktuar para fushatës zgjedhore dhe për shpërdorimin e burimeve publike në mbështetje të subjekteve zgjedhore

BAZA LIGJORE: Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f ” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 8, pikat 1 dhe 2, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator,

KONSTATOJ:

Partia Demokratike më datë 18.02.2025, ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nëpërmjet adresës së postës elektronike e-mail, denoncimin e administruar në regjistrin e denoncimeve me nr. 35 ID.

Në këtë denoncim Partia Demokratike parashtron sa vijon: “Partia Demokratike ka marrë dijeni nëpërmjet publikimeve në media se Bashkia Fier ka organizuar një tender për organizimin e një

Data: 22.02.2025

Nr: 142
Ora: 12:00



“Për mos fillimin e procedurës administrative bazuar në denoncimin nr. 35 ID, datë 18.02.2025, të regjistrin të denoncimeve, të Partisë Demokratike/PD”

feste në bashkëpunim me shoqatën “Bashkimi i Fierakëve në Greqi”, e maskuar si aktivitet zgjedhor. Sipas dokumentave të siguruara në media, tenderi me objekt: “Festojmë me emigrantët fierakë në Greqi” është hapur më 6 Janar 2025 dhe fituesi është shpallur më 8 Janar 2025. Shpenzimet e këtij tenderi përfshijnë shërbim transporti me autobus për 30 persona, shpenzime pagese për 3 këngëtarë dhe koordinatorin e eventit. Z.Armando Subashi kryetar i Bashkisë Fier ka deklaruar se: “Ky aktivitet është ndaluar pasi nuk është bërë njoftimi pesë ditë përpara në KQZ. Aktiviteti në Athinë është zhvilluar, por pa bashkinë”.

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 2, të vendimit nr. 9, datë 09.03.2021, të Komisionit Rregullator, pasi shqyrtova paraprakisht çështjen, vlerësoj se informacioni apo të dhënat e treguara nuk krijojnë një bazë të mjaftueshme për të hetuar administrativisht shkeljet e mundshme.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 8, pikat 1 dhe 2, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

V E N D O S:

1. Mos fillimin e procedurës administrative të denoncimit nr. 35, datë 18.02.2025, të Partisë Demokratike.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet adresës së postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI